

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: Partia Demokratike Dega Fier

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 328 “ Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve”, Neni 328/a “Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike”.

KUNDER: [REDAKTUAR] kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

DREJTUAR: PROKURORISË Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 dhe 75/a të K.Pr.Penale, si dhe neneve 328, dhe 328/a të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe 75/a parashikon se:

Neni 280

Marrja dizeni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dizeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dizeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.